

Datë: 19.11.2018

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-11834 të datës 24.03.2017 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit nr. 02/2018 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 14.08.2018 si dhe në bazë të vendimit 01-104-70441 të datës 05.11.2018 të Komisionit të ankesave dhe në bazë të procesverbalit nr. 19/2018 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 19.11.2018 komisioni përkatës vendosi njëzëri të rishpall:

KONKURIM TË HAPUR Nr.2/2018

Procedura Orig. Jedinica Orig. Unit	Nazari Bilaj Number	Shifra Klasifikimi Approval	Vendi Vendbanimi Value
11	463	73602	2

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Parcelat kadastrale:

- Nr.2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m², sipas planit rregullativ “depo ndërtimore”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)
5. Vlera e qarkullimit bankar për dy vitet e fundit e cila duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve që aplikon. (e vulosur nga Banka)
6. Garancioni bankar nga banka ose kompanit e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentët e kërkuara
 - Oferta ekonomiksht më e favorshme
 - Vlera e Investimeve – do të vlerësohet sipas çmimeve të tregut....20% të pikëve.
 - Çmimi për m² të parcelës - minimum 0.05 cent/m² në vit....5% të pikëve.
 - Numri i të punësuarve specifik po pozitë e deklaruar të punëtorëve - numri i punëtorëve duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve15% të pikëve
 - Lloji i veprimtarisë adekuate.... 20% të pikëve.
 - Lloji i veprimtarisë të ngjashme....5% të pikëve.
 - Plani dinamik- jo më shumë se 2 vite....15% të pikëve.
 - Projekti Ideor konform Planit Rregullues të hollësishëm Zona Industriale-Shirokë si dhe planit investiv, me :10% të pikëve.
- a) Situacioni i ngushtë me përpjesë 1:500 – ku specifikohet objekti, hyrja në situacion dhe objekt, rrugët, parkingjet, gjelbrimi si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme. Githashtu të shënohen dimensionet dhe sipërfaqja bruto e shpëtës së objektit

- b) Baza e përdhësës me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave, identifikim të hyrje/daljeve, kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.
- c) Baza e katit me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave, kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme. (nëse ka)
- d) Prerjet e objektit me përpjesë 1:100 – së paku dy prerje karakteristike
- e) Perspektiva
- f) Përshkrimi teknik për secilën fazë të punimeve
- g) Paramasa dhe Parallogaria – sipas çmimeve të tregut dhe të përputhet me projektin Ideor - Projekti dhe paramasa (sipas çmimeve të tregut) të jenë të vertetuara nga kompania projektuese. – të bashkëngjitet deklarata e kompanisë projektuese që projekti është projektuar sipas kushteve të planit rregullues të hollësishëm ZI dhe sipas normave teknike të projektimit.

-Vlera e qarkullimit bankar për 2 (dy) vitet e fundit-10% të pikëve

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria joadekuade do të diskualifikohet nga konkurimi.
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga aplikimi i hapur jo më vonë se 3 (tre) ditë nga hapja e ofertave.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **07.01.2019**, zyra pritëse të gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave deri më datë **10.01.2019** deri në ora **13:30** zyra pritëse të gjendja civile, Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet më **10.01.2019** në ora **14:00** në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.04/L-144.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708

emrush.bytyci@rks-gov.net



Kryesuesi i Komisionit
Emrush BYTYCI